



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 725 Akti

Nr. 501 Vendimi  
Tiranë, më 14.1.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 1 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Alma Faskaj</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 12.1.2022, në orën 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Zhaneta Pira**, inspektore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E”, të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi<sup>1</sup> në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vijim

<sup>1</sup> Takimi është zhvilluar online.

- ka hedhur shortin në datën 15.6.2021, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1 me përbërjen si më lartë.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 21.6.2021, është vendosur kryesuese znj. Pamela Qirko dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
  3. Nga relatorja janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
  4. Znj. Zhaneta Pira ka ushtruar detyrën e Inspektorit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit ndryshues nr. 76/2016, datë 22.7.2016, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës, është subjekt rivlerësimi.
  5. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit nuk është dakord me këtë konkluzion dhe përkundrazi në opinionin e tij, znj. Zhaneta Pira nuk ka cilësinë e një subjekti rivlerësimi dhe nuk është subjekt i Vettingut, por edhe nëse do të ishte subjekt, ajo nuk ka respektuar dhe përmbushur kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 165, të ligjit nr. 96/2016 dhe, për këtë arsye, duhet të shkarkohet (për më shumë referojuni opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar në dosje).
  6. Në vijim, trupi gjykues ka vlerësuar opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar në raport me legjislacionin në fuqi, praktikën e mëparshme të Komisionit, konkretisht, vendimin nr. 321/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Q. Z. dhe vendimit nr. 356/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit M. P., vendime që kanë marrë formë të prerë dhe ndaj të cilëve nuk është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik, si edhe vendimet e Kolegjit të Apelit, konkretisht qëndrimin e mbajtur prej tij në çështjen nr. 21 regjistër (JR), vendimi nr. 2/2021, për subjektin P. S., i cili ka ndryshuar vendimin nr. 249, datë 6.3.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vijim të të cilave ka vendosur se znj. Zhaneta Pira është subjekt i ligjit të Vettingut dhe se duhet t'i nënshtrohet rivlerësimit kalimtar.
  7. Në datën 14.12.2021, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Zhaneta Pira, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
  8. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
  9. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit Zhaneta Pira në seancë dëgjimore, datë 12.1.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
  10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.1.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
  11. Në këtë seancë dëgjimore subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Zhaneta Pira në seancën e datës 14.1.2022, në të cilën subjekti ishte prezent.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- ë) denoncimet nga publiku;
- f) opinionin me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

15. Subjekti i deklaratimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>2</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

16. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

17. Në vijim, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka realizuar<sup>3</sup> një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi për subjektin e rivlerësimit Zhaneta Pira.

18. Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

<sup>2</sup>“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.

<sup>3</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.

**1. Apartament banimi me sip. 100 m<sup>2</sup>**, (dy dhoma e kuzhinë), kontraktuar në vitin 2002, blerë në vitin 2006, me vlerë 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga shitja e apartamentit të privatizuar në qytetin e Peshkopisë dhe kursimet familjare.

1.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklarinimin fillestar në vitin 2003, deklaroi: *“Apartament banimi 2+1, i ndërtuar pas viteve ‘90, në bashkëpronësi me bashkëshortin dhe djalin e madh, me sip. 91 m<sup>2</sup>, blerë në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, me vendndodhje rruga ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, ap.\*\*\*, Tiranë”*.

1.2 ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar<sup>4</sup> për ILDKPKI-në pronësinë e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, shtetasit A. P., duke përcjellë dokumentacionin e disponuar, nga verifikimi i të cilit rezultoi se:

- a) sipas Vërtetimit Hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.9.2002, kjo pasuri figuronte e regjistruar në emër të shtetasit V. B.;
- b) në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë nënshkruar Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2006, me palë shitëse shtetasit V. dhe D. B. për blerjen e kësaj pasurie me sip. 100 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.3 Nga verifikimi nëpërmjet sistemit *online* të ASHK-së rezultoi se aplikimi për regjistrimin e kësaj pasurie është bërë në datën 25.5.2006 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Tatimi mbi të ardhurat e përfituara është paguar nga pala shitëse me mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 25.5.2006, për vlerën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë.

1.4 Në përgjigjet e pyetësorit standard<sup>5</sup> subjekti i rivlerësimit deklaroi se blerja e kësaj pasurie është realizuar në vitin 2002 dhe mënyra e pagimit ka qenë me dy këste, duke përfunduar pagesa në vitin 2003. Subjekti Zhaneta Pira nuk ka paraqitur dokument, kontratë apo dokumentacion justifikues për të provuar pagesën e çmimit prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, të deklaruar prej saj në DPV-në e vitit 2003 dhe as mbi pagesën e kryer me dy këste.

1.5 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me diferencën e vlerës së deklaruar me çmimin në kontratë dhe, në përgjigjen e pyetësorit të datës 1.10.2021, sqaron:

*“Në kontratën e shitblerjes së apartamentit të finalizuar në vitin 2006 është shënuar vlera e tij në shumën 1.900.000 lekë, por në fakt vlera reale e apartamentit ka qenë aq sa e kam deklaruar unë, 3.500.000 lekë. Ky ndryshim ka ardhur për shkak se pronari i pallatit nuk donte të pasqyroste vlerën reale në kontratë, për të mos paguar taksë të lartë të 0,5% të vlerës së pronës së shitur. Megjithëse unë në këtë apartament kisha filluar të banoja nga muaji mars i vitit 2003, kontrata u finalizua vetëm në vitin 2006. Kur unë kundërshtova noterin që të mos vendosej shifra jo reale në kontratë, por nga ana e pronarit ndërtues u urdhërua ajo, që të anulohet kontrata. Unë nuk mund të anulohet kontratën e të dilja nga apartamenti pas tre vitesh, pasi kisha kryer investime në të, si grila, tenda dielli, etj., prandaj u detyrova të nënshkruaja atë. Aktmarrëveshje nuk kemi pasur me shkrim dhe pagesat janë bërë në dorë, pronarit ndërtues.”*

1.6 Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të Entit Kombëtar të Banesave, vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2003 për qytetin e Tiranës ka qenë 53.450 (pesëdhjetë e tre e katërqind e pesëdhjetë) lekë për sipërfaqe shfrytëzimi. Sipas një përlllogaritjeje vlera totale e shitjes së kësaj pasurie me sipërfaqe totale 100 m<sup>2</sup> është 5.345.000 (pesë milion e treqind e dyzet e pesë mijë) lekë. Pra, rezultoi se çmimi i blerjes, i deklaruar nga subjekti prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, ka qenë më i ulët se çmimi referencë i EKB-së prej 5.345.000 (pesë milion e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh.

<sup>4</sup>Shihni shkresën nr.\*\*\* prot., datë 26.3.2018.

<sup>5</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 9 në pyetësorin e datës 27.7.2021.

1.7 Komisioni ka kryer verifikim nëpërmjet sistemit *online* të ASHK-së për kontrata të ngjashme të lidhura me palën shitëse shtetasin V.B. në objektin e banimit ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit. Konkretisht, rezulton se shtetasi V.B. ka qenë në cilësinë e pronarit të truallit ku është ndërtuar ky objekt banimi dhe paralelisht investitorit. Për pasuri të ngjashme me sip. 100 m<sup>2</sup> janë lidhur kontrata shitblerjeje<sup>6</sup> në vitin 2002 me çmim shitje 1.950.000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 1.000.000 (një milion) lekë. Ndërkohë që për një apartament banimi me sipërfaqe më të vogël, rreth 87 m<sup>2</sup>, është lidhur kontrata e shitblerjes në vitin 2002, me çmim shitjeje 3.900.000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekë. Ndërsa në vitin 2006 rezulton<sup>7</sup> se për një pasuri të ngjashme me sip. 100 m<sup>2</sup> është lidhur kontrata e shitblerjes në vlerën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë.

1.8 Sa më sipër, rezulton se kjo pasuri figuron e regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, sipas Kontratës së Shitblerjes së vitit 2006, në vlerën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë. Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të e viteve 2003 - 2004 se vlera reale e paguar prej saj, *cash*, është 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Duket se vlera më e ulët në kontratë është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore ndaj shtetit.

- **Lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e kësaj pasurie**

1.9 Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting* si burim të ardhurash për çmimin e blerjes 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë: (i) të ardhura nga shitja e apartamentit të privatizuar në Peshkopi; dhe (ii) të ardhura nga kursimet familjare.

*i) Shitja e apartamentit të privatizuar në Peshkopi*

1.10 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën Fillestare të vitit 2003 si burim krijimi shitjen e apartamentit të banimit që kanë pasur në qytetin e Peshkopisë përpara se të transferoheshin në Tiranë, pas privatizimit dhe nga kursimet familjare.

1.11 ZVRPP-ja Dibër ka konfirmuar për ILDKPKI-në<sup>8</sup> se pasuria me sip. 54 m<sup>2</sup> ka qenë e regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe djalit I. P., duke përcjellë edhe dokumentacionin e disponuar.

1.12 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ZVRPP-së Dibër rezulton se:

- a) Në datën 27.5.1993 është nënshkruar kontrata e privatizimit të banesës me palë ish Ndërmarrja Komonale të Banesave dhe qiramarrësin A. P.. Vlera e privatizimit prej 4.740 lekësh është paguar menjëherë me mandatarkëtimin datë 27.5.1993. Njëkohësisht, është nënshkruar edhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie me palë blerës A. P..
- b) Me vërtetimin nr. \*\*\* regj., datë 31.7.1993, është vlerësuar pasuria sipas çmimeve të liberalizuara në shumën 348.000 (treqind e dyzet e tetë mijë) lekë.

1.13 Në vijim, ky apartament është shitur me aktin noterial për kalim në pronësi të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.6.2003, me palë blerëse G. Sh. në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, i cili e ka regjistruar në datën 12.6.2003.

1.14 Referuar Udhëzimit nr.1, datë 8.5.2003, të Entit Kombëtar të Banesave, vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2003 për qytetin e Dibrës ka qenë 22.828 (njëzet e dy mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë/sipërfaqe shfrytëzimi. Sipas një përlllogaritjeje, vlera totale e shitjes së kësaj pasurie me sipërfaqe totale 54 m<sup>2</sup> është 1.232.712 (një milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë. Pra, rezulton se çmimi i shitjes së kësaj pasurie në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë ka qenë më i ulët se çmimi referencë i EKB-së prej 1.232.712 (një milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

<sup>6</sup>Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.9.2002, me palë shitëse V. B., palë blerëse M. P., për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup>, dhe çmim 1.950.000 lekë.

<sup>7</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.6.2006, me palë shitëse V. B., palë blerëse B. M. për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup> dhe çmim 1.900.000 lekë.

<sup>8</sup>Shihni shkresën nr.\*\*\* prot., datë 17.8.2017.

## ii) Kursimet familjare

1.15 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësorin standard<sup>9</sup> se djali i saj I. P. ka studiuar në Turqi në periudhën 1994 – 2003 dhe, fillimisht, ka ndjekur studimet në shkollën e mesme ushtarake në qytetin e Izmirit dhe më pas në Akademinë Ushtarake në Ankara. Subjekti i rivlerësimit shprehet se shpenzimet e shkollimit të djalit janë mbuluar nga shteti turk dhe nga prej saj nuk është kryer asnjë pagesë.

1.16 Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit vënien në dispozicion të dokumentacionit për të provuar se shkollimi dhe shpenzimet e jetesës së djalit I. P. janë mbuluar nga shteti turk.

1.17 Në përgjigjet e pyetësorit datë 1.10.2021, subjekti sqaron<sup>10</sup> se pranimi dhe regjistrimi në këto shkolla ushtarake të djalit I. P. është bërë në bazë të një marrëveshjeje midis Ministrisë së Mbrojtjes shqiptare dhe Ministrisë së Mbrojtjes turke në vitin 1993. Subjekti shprehet se: *“Në këtë marrëveshje, përveç parashikimit për pranimin e studentëve shqiptarë në shkollat ushtarake turke, ka pasur edhe çështje të tjera ushtarake, që kishin të bënin me aspekte të organizimit dhe bashkëpunimit në fushën ushtarake midis qeverive të dy shteteve dhe që përbëjnë sekret ushtarak. Me gjithë tentativat e kryera nga djali pranë Ministrisë së Mbrojtjes shqiptare, ishte e pamundur objektivisht të jepej një kopje e kësaj marrëveshjeje. Në vitin 1994, kur ka nisur studimet djali, nuk kishin filluar ende të funksiononin shkollat private. Megjithatë, të gjitha shkollat ushtarake, kudo në botë, financohen nga shteti”*.

1.18 Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur si dokumentacion:

- fletën e marrëveshjes së nënshkruar të nxjerrë nga faqja zyrtare e Ministrisë së Jashtme;
- kopje e diplomës nr. \*\*\*, datë 30.8.2002, të lëshuar nga Akademia Ushtarake Turke;
- dëshmi nr. \*\*\* regj., datë 5.2.2011, për njohje diplome nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

1.19 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit disponon një kopje të fletës së marrëveshjeve të nënshkruara me shtetin turk, ku ndër to citohet marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e përgatitjes ushtarake, teknike dhe shkencore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, nënshkruar më 19.11.1992 dhe hyrë në fuqi më 10.3.1993. Shtetasi I. P. rezulton se është pajisur nga shteti turk me diplomën nr. \*\*\*, datë 30.8.2002, e cila është njohur nga shteti shqiptar me dëshminë nr. \*\*\* regj., datë 5.2.2011.

1.20 Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues për periudhën 1993 – 2002, si dhe është jashtë periudhës së rivlerësimit, Komisioni ka marrë në konsideratë deklarimin e subjektit në pyetësorë lidhur me faktin që nuk ka pasur shpenzime për studimet e djalit në Turqi.

1.21 Komisioni ka përgatitur analizën financiare<sup>11</sup> për blerjen e pasurisë apartament banimi me vlerën e deklaruar nga subjektit të rivlerësimit prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh.

Analizë kumulative 1994 – 2003	Vlera në lekë
Blerje apartamenti	3.500.000
<b>Të ardhura totale</b>	<b>5.419.760</b>
Të ardhura të dokumentuara nga pagat	4.719.760
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Peshkopi	700.000
<b>Shpenzime totale</b>	<b>1.926.738</b>
Shpenzime jetese <sup>12</sup>	1.926.738
Shpenzime për djalin në Turqi	-
<b>Rezultati neto</b>	<b>- 6.978</b>

<sup>9</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 10 në pyetësorin e datës 27.7.2021.

<sup>10</sup>Shihni përgjigjen nr. 3 të pyetësorit datë 1.10.2021.

<sup>11</sup>Shpenzimet jetike janë llogaritur në masën 30%, referuar vendimeve të Kolegjit të Apelit, nr. 15/2021 për subjektin K. S. dhe nr.14/2021 për subjektin I. B..

<sup>12</sup>Shpenzimet e jetës janë llogaritur në vlerën 30% sipas vendimit nr. 15/2021 të Kolegjit për subjektin K. S. dhe vendimit nr. 14/2021 të Kolegjit për subjektin I. B. për periudhën 1994 – 1999 dhe për periudhën pasardhëse sipas ILDKPKI-së.

1.22 Në përfundim konstatohet se:

- a) Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë se çmimi i blerjes së kësaj pasurie ka qenë 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë (i cili mbetet deklarativ deri në këto momente) dhe jo 5.345.000 (pesë milion e treqind e dyzet e pesë mijë) lekë sipas çmimit të referencës.
- b) Subjekti i rivlerësimit duket se ka kryer veprime ligjore për të shmangur detyrimet tatimore ndaj shtetit, duke favorizuar palët e treta.

1.23 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.24 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon:

- a) Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie të deklaruar në vlerën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, subjekti i rivlerësimit shpjegon se marrëveshja me pronarin e pallatit është lidhur verbalisht që në vitin 2001, zona ku po ndërtohej pallati ishte e pabanuar, pa infrastrukturë dhe ky ishte pallati i parë që po ndërtohej. Subjekti i rivlerësimit citon: *“Ndërtimi i pallatit ka zgjatur mbi dy vjet dhe kemi hyrë në këtë apartament në pranverën e vitit 2003. Zona ku ndodhet pallati, nuk ka qenë e preferuar në atë kohë, pasi ishte zonë industriale dhe nuk kishte infrastrukturë, kështu që ky ishte çmimi sipas kërkesës së tregut në atë zonë”*.
- b) Për sa i përket konstatimit mbi veprimet ligjore të kryera për shmangien e detyrimeve tatimore ndaj shtetit, duke favorizuar palët e treta, subjekti i rivlerësimit shpjegon se çmimi real prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, të paguar për apartamentin e ka deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2003, para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në vitin 2006, ku pasqyrohet çmimi prej 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekësh. Subjekti i rivlerësimit argumenton se deklarimi ka qenë real duke pasqyruar të vërtetën lidhur me çmimin e apartamentit pa e ditur se mund të sillte ndonjë pasojë: *“Çmuj se ky qëndrim i imi për të pasqyruar të vërtetën lidhur me çmimin real të apartamentit nuk duhet të më penalizojë, pasi nuk kam pasur asnjë përfitim. E kundërta do të ishte nëse unë nuk do ta deklaroja çmimin e vërtetë të apartamentit”*.

1.25 Lidhur me vlerën e deklaruar dhe atë sipas kontratës, subjekti i rivlerësimit shprehet se vlerën e apartamentit e kishte likuiduar në vitin 2003 dhe kur u nënshkrua Kontrata e Shitblerjes në vitin 2006 nuk mund ta anulonte e të dilte nga shtëpia, pasi gjatë këtyre tre viteve kishte kryer investime. Subjekti i rivlerësimit citon: *“Në asnjë moment nuk kam dashur të favorizoj shitësin e apartamentit në këtë rast, por siç kam deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë Vetting, unë e kisha likuiduar çmimin e apartamentit qysh në vitin 2003 dhe nuk mund të dilja nga apartamenti në vitin 2006, pasi kisha bërë investime në të”*.

1.26 Në vlerësim të fakteve të rezultuara nga hetimi, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe arsytimit ligjor mbështetur edhe në vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit, trupi gjykues ka vlerësuar se deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2003 duhet të konsiderohen provë për procesin e rivlerësimit, duke e pranuar këtë deklaram si një dokument të kohës kur është kryer veprimi. Lidhur me vlerën e deklaruar prej 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh nga subjekti si dhe asaj sipas çmimit të referencës së EKB-së prej 5.345.000 (pesë milion e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh, llogaritur sipas vlerave në tregun e lirë për vitin 2003 për qytetin e Tiranës, trupi gjykues arsyeton se çmimi i tregut për vitin 2003 i referohet vlerës referuese për apartamentet në qytetin e Tiranës, pa përcaktuar zonat përkatëse<sup>13</sup>, pra duke referuar të njëjtin çmim si në qendër, ashtu edhe në periferi. Fakti se subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë apartament në një zonë jo shumë të zhvilluar si dhe referuar edhe çmimeve të ngjashme për blerjen e pasurisë nga banorë të tjerë në këtë pallat, e bën të besueshëm për trupin gjykues faktin se vlera e kësaj pasurie është ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*.

<sup>13</sup> Siç edhe është specifikuar më vonë në vite.

1.27 Lidhur me veprime ligjore të kryera prej saj dhe personave të lidhur që kanë ndihmuar për të shmangur detyrimet tatimore ndaj shtetit për palën shitëse, duke favorizuar kështu palët e treta, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë ka ndodhur edhe se veprimet e subjektit nuk janë korrekte. Duke vlerësuar edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me rrethanat në të cilat është gjendur, trupi gjykues vlerëson se kjo shkelje nuk është e tillë që të sjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, por mund të vlerësohet në tërësi në kuadër të rivlerësimit etik dhe profesional të subjektit, si dhe në raport proporcional me kohën, rrethanat dhe rezultatet e tjera të hetimit për këtë subjekt.

**2. Apartament banimi me sip. 71.45 m<sup>2</sup>, 1+1, në \*\*\*, Komuna Kashar, në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit I. P..** Personi i lidhur/shtetasi I. P. deklaron se ky apartament është blerë me Kontratën Premtim Shitje të vitit 2009, në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat e djalit të subjektit të rivlerësimit I. P. dhe të familjes. Pjesa takuese: 100% e shtetasit I. P..

2.1 Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Rurale 2 konfirmon<sup>14</sup> për Komisionin se shtetasi I. P. është përfshirë në procedurat e legalizimit për këtë pasuri dhe është pajisur me Leje Legalizimi nr. \*\*\*, datë 8.6.2021, duke përcjellë edhe dokumentacionin e disponuar.

2.2 Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka përcjellë<sup>15</sup> kartelën e arkëttimeve dhe statementin bankar të pagesave të kryera nga shtetasi I. P., nga ku rezulton se janë kryer pagesat përkatëse: e para në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në datën 28.12.2009; pagesa e dytë në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro në datën 5.7.2010; dhe pagesa e fundit në vlerën 7.580 (shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) euro në datën 18.7.2012. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. konfirmon<sup>16</sup> se pagesat e kryera nga shtetasi I. P. në vlerën totale 28.580 (njëzet e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) euro dhe sqaron Komisionin se vlera 7.200 (shtatë mijë e dyqind) lekë e mbetur në kartelën e detyrimeve përfaqëson rivlerësim të monedhës euro/lekë në fund të vitit.

2.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-të e viteve 2010 dhe 2012 blerjen e kësaj pasurie, pagesat financiare të kryera për likuidimin e vlerës shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe as detyrimin ndaj shoqërisë, referuar kërkesave të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, “Për deklarimin e pasurisë”.

2.4 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit për këto mosdeklarime, e cila në përgjigjen e pyetësorit të datës 1.10.2021, sqaron se: *“Meqenëse djali I. P. në vitin 2010 ishte vetë subjekt deklarues, si drejtor Drejtorie në Shërbimin Informativ të Shtetit për këtë periudhë që përmendet, ai e ka bërë vetë deklarimin e apartamentit që kishte prenotuar dhe unë kam çmuar se kjo ka qenë e mjaftueshme. Sqaroj se në atë vit, apartamenti ishte ende në ndërtim dhe djali nuk e kishte marrë në dorëzim. Siç rezulton nga librezat e energjisë elektrike dhe të ujit, djali ka paguar detyrimet nga viti 2013 e në vazhdim vetëm sa i përket tarifës fikse të shërbimit, pasi në apartament nuk banonte njeri. Djali nuk ka jetuar asnjë ditë aty, pasi kemi jetuar bashkë në apartamentin tonë. Apartamenti i djalit deri në fundin e vitit 2019 ka qenë pa asnjë orendi, pra bosh. Edhe më pas ai nuk ka banuar fare aty, pasi qysh nga viti 2018 e në vazhdim ai jeton në Shkup të Maqedonisë së Veriut, me detyrë diplomat në Ambasadën Shqiptare në Shkup”.*

2.5 Pas kërkesës nga Komisioni, ILDKPKI-ja ka përcjellë<sup>17</sup> deklaratimet periodike të kryera nga shtetasi I. P., i cili rezultoi deklarues në vitet 2009 – 2013 dhe më pas 2016 -2017. Nga dokumentacioni rezulton se shtetasi I. P. nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 krijimin e kësaj pasurie dhe kontratën e premtim shitjes. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga ky shtetas në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2016.

<sup>14</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2021.

<sup>15</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2021.

<sup>16</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2021.

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021.



2.6 Duket se deklarimi i kësaj pasurie është bërë për efekt të plotësimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuri që nuk i ka deklaruar në deklaratimet e mëparshme.

- **Lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e kësaj pasurie**

2.7 Personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit I. P., ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se kjo pasuri është blerë me të ardhurat e tij dhe të familjes. Pagesa e kështit të parë dhe të dytë në vlerën 21.000 (njëzet e një mijë) euro është realizuar deri në datën 5.7.2010. Komisioni ka përgatitur analizën financiare kumulative për periudhën 2005 – 5.7.2010, për të gjithë familjen.

<b>Analizë 2005 - 5.7.2010</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Kësti I dhe II apartamenti	2.890.410
<b>Të ardhura totale</b>	<b>10.664.700</b>
Të ardhura të dokumentuara nga paga <sup>18</sup>	10.486.100
<b>Shpenzime totale</b>	<b>3.865.104</b>
Shpenzime jetese	2.741.699
Shpenzime të tjera (sistemi <i>TIMS</i> /arredim)	1.123.406
Blerje automjeti + shpenzime doganore	598.821
Pakësim likuiditetesh (bankat)	-300.859
<b>Rezultati neto</b>	<b>3.432.624</b>

2.8 Bazuar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur të ardhura financiare me burime të ligjshme për të paguar dy këstet e para të apartamentit në total vlerën 2.890.410 (dy milionë e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) lekë.

2.9 Pagesa e kështit të tretë në vlerën 7.580 (shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) euro është kryer në datën 18.7.2012. Komisioni ka përgatitur analizën financiare deri në datën 18.7.2012, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët janë në një pamundësi financiare në vlerë të ulët prej 16.589 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh.

<b>Analizë janar - korrik 2012</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Kësti III apartamenti ( 7.580 euro)	1.059.078
Shtesë likuiditetesh (bankat)	131.969
<b>Të ardhura totale</b>	<b>1.696.391</b>
Të ardhura të dokumentuara nga paga	1.696.391
<b>Shpenzime totale</b>	<b>521.934</b>
Shpenzime jetese	325.612
Shpenzime sistemi <i>TIMS</i>	74.067
Shpenzime për studimet e djalit D. P.	122.255
<b>Rezultati neto</b>	<b>-16.589</b>

2.10 Në përfundim për këtë pasuri:

- Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë se pse nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* detyrimin ndaj shoqërisë së ndërtimit në vlerën 1.420 (një mijë e katërqind e njëzet) euro.
- Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë se pse nuk ka deklaruar këtë pasuri, pagesat e kryera prej saj dhe detyrimin ndaj shoqërisë në deklaratat periodike vjetore të viteve 2010 – 2012 e në vijim, në respektim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

2.11 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2.12 Në shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar si vijon:

<sup>18</sup> Deri në këto momente nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga dietat të përfituara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 320.900 lekë.

a) Lidhur me konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të detyrimit ndaj shoqërisë në vlerën 1.420 (një mijë e katërqind e njëzet) euro, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pagesa e këstit të tretë dhe të fundit të këtij apartamenti është likuiduar në vitin 2012 dhe nuk kanë pasur detyrim të papaguar. Subjekti i rivlerësimit citon: “Në vitin 2017 kur kam deklaruar pasurinë në deklaratën *Vetting* nuk kemi pasur asnjë detyrim ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., pasi kësti i tretë dhe i fundit për apartamentin e djalit është paguar në vitin 2012”.

b) Për sa i përket konstatimit në raport për mosdeklarimin e pasurisë, pagesave të kryera dhe detyrimeve ndaj shoqërisë, subjekti i rivlerësimit shprehet: “Meqenëse djali I. P. në vitin 2010 e në vazhdim ka qenë vetë subjekt deklarues, si drejtor Drejtorie në Shërbimin Informativ të Shtetit, unë kam çmuar se ai si pronar i apartamentit e ka bërë vetë deklarimin e kontratës premtim shitje të apartamentit që kishte prenotuar. Në këto rrethana, unë kam çmuar se nuk kisha detyrim ta deklaroja. Vitet e para të përpilimit të deklaratave vjetore, mund të kem pasur edhe pasaktësi, pasi nuk i kishim fare të qarta kërkesat për deklarim, por edhe nga ana e ILDKPI-së nuk më është bërë ndonjë ndërhyrje për parregullsi për sa më sipër”.

2.13 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pasaktësitë e subjektit në plotësimin e deklaratave periodike vjetore janë rregulluar gjatë deklarimit *Vetting*. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* rezultuan të vërteta, dhe gjatë hetimit të kësaj pasurie nuk rezultuan dyshime për mosdeklarime të qëllimshme nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të. Pasaktësitë që rezultuan nga deklaratimet periodike vjetore rezultuan të përmbushura në deklaratën *Vetting*.

**3. Automjet tip “Renault Clio”, viti i prodhimit 2001, regjistruar në DRSHTRR më 9.12.2008, në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, I. P..** Personi i lidhur/shtetasi I. P. deklaron se ky automjet është blerë në vlerën 3.400 (tre mijë e katërqind) euro dhe 180.000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë shpenzime doganore.

3.1 DPSHTRR-ja konfirmon<sup>19</sup> për Komisionin se automjeti me targa \*\*\* ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit I. P., duke përcjellë edhe dosjen e automjetit.

3.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se:

a) Automjeti tip “Renault Clio”, viti i prodhimit 2001, me targa \*\*\* dhe targa në rast transferimi \*\*\* figuron se ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga Dogana Tiranë më 5.9.2008 dhe detyrimi doganor i paguar është në vlerën 172.293 (njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë. Certifikata e Pronësisë e mëparshme e automjetit nr. \*\*\*, datë 22.8.2008, tregon se vendi i origjinës së këtij automjeti ka qenë Italia me pronar shtetasin M. Ç..

b) Sipas Prokurës së Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.8.2008, shtetasi M. Ç. ka emëruar si përfaqësues të tij shtetasin H. H. për kryerjen e gjithë veprimeve të nevojshme me qëllim shitjen e këtij automjeti.

c) Në datën 3.9.2008 është nënshkruar Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me palë shitëse shtetasin M. Ç., i përfaqësuar me prokurë dhe palë blerëse shtetasin I. P. për automjetin e mësipërm në vlerën 3.400 (tre mijë e katërqind) euro, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

ç) Sipas Certifikatës së Pronësisë datë 9.12.2008, automjeti me targa \*\*\* është regjistruar në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit, shtetasit I. P..

3.3 Automjeti, me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2017, është shitur nga shtetasi I. P. te vëllai i tij, shtetasi D. P., në vlerën 2.000 (dy mijë) euro, likuiduar jashtë zyrës së noterisë.

3.4 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për blerjen e këtij automjeti.

3.5 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika.

<sup>19</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021.

**4. Automjet tip “Renault Laguna”, viti i prodhimit 2000, regjistruar në DRSHTRR më 5.2.2015, në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, shtetasit I. P.. Personi i lidhur/ shtetasi I. P. deklaroi se ky automjet është blerë në vlerën 290.000 (dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat personale dhe të familjes.**

4.1 DPSHTRR-ja konfirmon<sup>20</sup> për Komisionin se automjeti me targa \*\*\* ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit I. P., duke përcjellë edhe dosjen e automjetit.

4.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezultoi se:

a) Automjeti tip “Renault Laguna”, viti i prodhimit 2000, rezultoi se është blerë nga shtetasi P. K. në Gjermani nga shoqëria “\*\*\*\*” sipas vërtetimit datë 21.2.2013, me çmim blerjeje 1.000 (një mijë) euro.

b) Ky automjet, sipas deklaratës doganore, është zhdoganuar më 10.3.2012, në Doganën Durrës nga shtetasi P. K. dhe detyrimi doganor i paguar nga ky shtetas është në vlerën 16.283 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

c) Nëpërmjet Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.2.2015, ky automjet me palë shitëse shtetasin P. K. është blerë nga djali i subjektit të rivlerësimit në vlerën 290.000 (dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

4.3 Në datën 28.4.2018 është nënshkruar Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me palë shitëse shtetasin I. P. dhe palë blerëse shtetasen A. M. për automjetin e mësipërm në vlerën 1.700 (një mijë e shtatëqind) euro, e paguar jashtë zyrës noteriale.

4.4 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për blerjen e këtij automjetit.

4.5 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika.

## **5. Gjendje *cash*, kursime familjare**

5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendje *cash* dhe kursime familjare në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 25%.

5.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë *cash* në DPV-në e vitit 2012 në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat familjare.

5.3 Në DPV-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, me pjesë takuese 50%, me burim krijimi nga kursimet familjare.

5.4 Në DPV-në e vitit 2014 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, me pjesë takuese 50%, me burim krijimi nga kursimet familjare.

5.5 Në DPV-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, me pjesë takuese 50%, me burim krijimi nga kursimet familjare.

5.6 Në DPV-në e vitit 2016 subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, me pjesë takuese 25%, me burim krijimi nga kursimet familjare.

5.7 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, deklaratimet vjetore të gjendjes *cash* në banesë përputhen me deklaratimin e gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting*, të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

5.8 Nga analiza financiare për periudhën 2013 – 2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitet përkatëse. Këto të dhëna janë pasqyruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

5.9 Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

**6. Depozitë kursimi** e subjektit në vlerën 760.931 (shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*.

6.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çdo vit këtë llogari kursimi në deklaratimet periodike vjetore.

<sup>20</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021.

6.2 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çelur në datën 6.2.2013 llogari kursimi në “Raiffeisen Bank” me balancë fillestare vlerën 5.000 (pesë mijë) lekë. Kjo llogari është shtuar çdo muaj me pagesa periodike mujore të transferuar nga llogaria e pagës, duke arritur në vlerën 760.931 (shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë deri më 31.12.2016.

6.6 Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

**7. Depozitë kursimi** në vlerën 504.180 (pesëqind e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, në “Raiffeisen Bank”, e deklaruar nga djali i subjektit të rivlerësimit I. P. në deklaratën *Vetting*

7.1 Nga hetimi i lëvizjes së llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se është çelur depozita në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë në datën 17.9.2013 dhe fondet janë depozituar *cash* nga djali i subjektit të rivlerësimit. Kjo depozitë është rinovuar çdo vit në “Raiffeisen Bank”, duke ardhur në vlerën 504.180 (pesëqind e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, në datën 31.12.2016.

7.2 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për krijimin e kësaj depozitë në shtator të vitit 2013, duke marrë në konsideratë të ardhurat/shpenzimet e njësisë familjare për periudhën janar - shtator 2013, nga e cila rezulton se kanë mundësi financiare për krijimin e kësaj depozite.

7.3 Në përfundim nuk kanë rezultuar problematika lidhur me këtë pasuri.

## **GJETJE TË TJERA**

**8.** Sipas dokumentit/shkresës<sup>21</sup> të shoqërisë financiare “AK Invest” rezulton se në emër të shtetasit D. P., më 24.12.2015, është kryer një transfertë monetare në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, nga Gjermania, me dërgues shtetasin J. P. F..

8.1 Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë transfertë dhe në përgjigjet e pyetësorit datë 1.10.2021 subjekti i rivlerësimit ka sqaruar<sup>22</sup> se: *“Sa i përket dërgesës nëpërmjet Western Union në vlerën 5.000 euro për djalin D. P., deklaroj se unë nuk kam pasur asnjë dijeni, derisa kam lexuar pyetjen tuaj këtu. Djali lidhur me këtë dërgesë, më sqaron se ajo ka qenë kthimi i shumës së paguar më parë personit dhe përbën një rast të vetëm”*.

8.2 Nga të dhënat për këtë shtetas në dokumentin e dërgesës, Komisioni ka verifikuar në internet këtë shtetas, por nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie*, po ashtu nuk rezultuan të dhëna nga QKB-ja mbi ndonjë aktivitet tregtar apo një bashkëpunim tregtar midis këtij shtetasi dhe djalit të subjektit të rivlerësimit apo të tjerë, brenda territorit të Shqipërisë.

8.3 Nga verifikimi nuk rezultuan të dhëna për shtetasin D. P., djali i subjektit të rivlerësimit, që të jetë regjistruar për ushtrim aktiviteti tregtar gjatë periudhës së rivlerësimit *Vetting*. QKB-ja konfirmon regjistrimin e aktivitetit studio ligjore “\*\*\*” në datën 5.2.2021, në emër të shtetasit D. P..

8.4 Komisioni verifikoi në sistemin *TIMS* shtetasin J. P. F., nga ku rezultoi një shtetas me të dhënat J. F. i vitlindjes 1980, i cili ka udhëtuar në vitin 2017 drejt Shqipërisë dhe nga të dhënat duket si një udhëtim turistik. Nuk ka të dhëna të tjera lidhur me këtë shtetas.

8.5 Nisur nga fakti se shtetasi J. P. F., që kishte kryer transfertën nga shteti gjerman, nuk figuron të këtë hyrë në shtetin shqiptar apo të ketë pasur ndonjë veprimtari tjetër me djalin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kërkuar informacion nga INTERPOL-i, Policia e Shtetit, lidhur me ndonjë të dhënë për këtë shtetas. INTERPOL Tirana sqaron<sup>23</sup> se për dy shtetasit me gjeneralitetet J. F. që figurojnë nga kontrolli në sistemin *TIMS* nuk rezultojnë të dhëna në Interpol Arkiva dhe Interpol ASF2.

<sup>21</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

<sup>22</sup>Shihni përgjigjen nr. 5 të pyetësorit datë 1.10.2021.

<sup>23</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2021.

8.6 Komisioni ka kërkuar informacion nga SPAK-u, i cili informon<sup>24</sup> Komisionin se në emër të shtetasit J. P. F. nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

8.7 Në përfundim, rezulton se kjo huadhënie brenda vitit, sipas deklarimeve të djalit të subjektit të rivlerësimit, nuk është deklaruar. Nuk duket se familja të ketë qenë në pamundësi financiare për krijimin e shumës 5.000 (pesë mijë) euro. Nuk ka rezultuar se kjo pasuri (vlerë monetare) të jetë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie në vijim apo të dhëna për pasuri të padeklaruara. Nuk rezultuan të dhëna apo *indicie* për kontakte të papërshtatshme apo transaksione të dyshimta.

8.8 Komisioni i kërkoj sqarime subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë transfertë dhe shtetasin J. P. F.

8.9 Subjekti i rivlerësimit paraqiti të njëjtat shpjegime të dhëna edhe gjatë pyetësorëve të Komisionit: *“Siç kam deklaruar edhe në pyetësorin e datës 1.10.2021, dërguar Komisionit lidhur me këtë dërgesë, djali më ka sqaruar se ka qenë kthimi i shumës së dhënë më parë personit si pagesë investimi për blerje në Gjermani të disa pajisjeve, për një biznes ‘bar-kafe’. Kjo iniciativë i dështoi, duke u detyruar të kërkonte kthimin mbrapsht të shumës. Djali nuk është takuar asnjëherë me këtë person, pasi ndërmjetës për këtë blerje ishte bërë një shok i tij”*.

8.10 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhet përpara ndonjërit prej kushteve të përcaktuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe të parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji, në raport me procesin e rivlerësimit për subjektin rivlerësues Zhaneta Pira.

**9. Automjet tip “Reanult”,** të cilin subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017 për përdorim vetjak, blerë me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2017, regjistruar në emër të djalit D. P.. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare.

9.1 Komisioni ka verifikuar këtë pasuri dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016 ka vlerësuar se verifikimi i pasurive të subjektit për periudhën 2017-2018-2019-2020 e në vijim është një proces që duhet të kryhet nga organet kompetente të përcaktuara sipas ligjit. Ky arsyetim vjen edhe bazuar në vendimin nr. 25/2020 të Kolegjit.

**10. Automjet tip “Toyota Camry”,** viti i prodhimit 2004, me targa \*\*\*, blerë nga djali i subjektit të rivlerësimit I. P., më 28.10.2017.

10.1 Komisioni ka verifikuar këtë pasuri dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016 ka vlerësuar se verifikimi i pasurive të subjektit për periudhën 2017-2018-2019-2020 e në vijim është një proces që duhet të kryhet nga organet kompetente të përcaktuara sipas ligjit. Ky arsyetim vjen edhe bazuar në vendimin nr. 25/2020 të Kolegjit.

**11. Automjet tip “Peugeot”,** viti i prodhimit 2003, me targa \*\*\*, blerë nga djali i subjektit të rivlerësimit D. P. më 4.9.2020.

11.1 Komisioni ka verifikuar këtë pasuri dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016 ka vlerësuar se verifikimi i pasurive të subjektit për periudhën 2017-2018-2019-2020 e në vijim është një proces që duhet të kryhet nga organet kompetente të përcaktuara sipas ligjit. Ky arsyetim vjen edhe bazuar në vendimin nr. 25/2020 të Kolegjit.

## **12. Analiza financiare për periudhën 2010 – 2016**

12.1 Njësia e Shërbimit Ligjor ka kryer analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të së cilës rezultoi se znj. Zhaneta Pira dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara.

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

<sup>24</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2021.

19. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në deklaratën *Vetting*, dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara ndër vite dhe shpenzimet e realizuara. Pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike vjetore, nga hetimi nuk rezultuan se kanë qenë të qëllimshme apo kanë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklaram të rremë. Subjekti nuk rezultoi në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit.

19.1 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor për periudhën 2010 – 2016, nuk ka rezultuar mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet, e se subjekti ka pasur një rezultat pozitiv.

19.2 Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe se pasuritë e krijuara prej tyre, ndër vite, janë deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting* dhe rezultojnë me burime të ligjshme.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

20. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, subjekti ka dërguar në datën 31.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Zhaneta Pira, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, raport të cilin e ka deklasifikuar plotësisht.

21. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2021, i ka kërkuar DSIK-së përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit Zhaneta Pira, përderisa raportit pararendës kishte kryer verifikimet deri në dhjetor të vitit 2017, e më tej, deklasifikim të raportit.

22. DSIK-ja, pas verifikimit nuk ka sjellë të dhëna shtesë për këtë subjekt rivlerësimi e në vijim në datën 5.10.2021, ka dërguar raportin e deklasifikuar për këtë subjekt rivlerësimi.

23. Gjatë procesit të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Zhaneta Pira.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

24. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

24.1 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

25. Subjekti rivlerësimit Zhaneta Pira, me hyrjen në fuqi të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtruar funksionin e inspektorit në KLD. Mbështetur në pikën 3, të nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës znj. Zhaneta Pira është subjekt rivlerësimi dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Lidhur me rivlerësimin e saj profesional, mbështetur në pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet për inspektorët që nuk janë magistratë se vlerësohen bazuar në: (a) relacionin dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe (b) rezultatit e testimin në Shkollën e Magjistraturës.

26. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në korrik të vitit 1988 dhe në datën 1.7.1994 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Më pas, me kërkesën e saj dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.3.2003, të KLD-së, subjekti është liruar nga detyra e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe me urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.2.2003, të ministrit të Drejtësisë është emëruar inspektore në Sektorin e Inspektimit Gjyqësor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

26.1 Me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.9.2010, të KLD-së është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për një mandat 5-vjeçar në këtë detyrë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2016, të KLD-së është riemëruar inspektore për një mandat tjetër.

27. Në vijim, Komisioni ka vlerësuar se znj. Zhaneta Pira duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si inspektore pranë KLD-së në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës.

28. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka statusin e gjyqtares që shërben në institucione të tjera, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr. 9877/2008, i ndryshuar, pasi ka qëndruar në detyrën e inspektore për një periudhë që tejkalon disa herë afatin 3-vjeçar të vendosur nga ligji<sup>25</sup>.

29. Në bazë të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 vlerësimi profesional duhet të kryhet mbështetur në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të paraqitura; dhe (b) rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës.

30. Nga verifikimi ka rezultuar se znj. Zhaneta Pira nuk i është nënshtruar testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, duke mos plotësuar kërkesat ligjore të nevojshme (sipas ligjit) në mënyrë kumulative, për rivlerësimin e saj profesional dhe se për të ka vetëm një raport vlerësimi nga KLGJ-ja, bazuar në kërkesat e germës “a”, të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016.

31. Kjo situatë e rezultuar e vendos subjektin para faktit se nuk ka përmbushur në mënyrë kumulative kërkesat ligjore për rivlerësimin e saj profesional.

32. Mbështetur në sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati hetimi të Komisionit.

33. Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me konstatimin e Komisionit për mospërmbushjen në mënyrë kumulative të kërkesave ligjore për rivlerësimin profesional, duke deklaruar se i përmbush të gjitha kërkesat ligjore për rivlerësimin profesional, pasi e ka ruajtur statusin e gjyqtarit dhe e ka të konfirmuar pasjen e këtij statusi nga organi kompetent, KLGJ, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, “Për deklarinimin e statusit të magjistratit për znj. Zhaneta Pira”.

33.1 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në periudhën 2003 – 2010, që ka punuar si inspektore në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë e ka ruajtur dhe gëzuar statusin e gjyqtarit. Subjekti ka referuar si bazë ligjore pikat 3 dhe 5, të nenit 4, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ku ndër të tjera parashikohet se periudha e ushtrimit të funksionit në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të karrierës profesionale.

33.2 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit e ka mbështetur këtë pretendim duke u bazuar edhe në pikën 4, të nenit 28, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”: *“Pra, duke qenë se kam kaluar menjëherë nga detyra e gjyqtares në atë të inspektore në Ministrinë e Drejtësisë, ku gëzoja statusin e gjyqtarit dhe më pas në detyrën e inspektore në*

<sup>25</sup>Neni 28 ligji nr. 9877, datë 18.2.2008.

*ish-KLD, në zbatim të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, 'Për organizimin e pushtetit gjyqësor, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2013, datë 11.4.2013' e kam gëzuar statusin e gjyqtarit për efekt të vjetërsisë në punë dhe pagës”.*

34. Për sa i përket konstatimit të Komisionit mbi tejkalimin e periudhës 3-vjeçare të parashikuar nga ligji për shërbimin në institucione të tjera, subjekti i rivlerësimit argumenton se ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë tri kërkesa për emërimin si gjyqtare në pozicionet e shpallura të lira në datat 30.11.2012, 5.5.2014 dhe 24.5.2016, por Këshilli nuk i ka marrë në konsideratë ato. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit sqaron se afati 3-vjeçar që ligji nr.9877/2008 parashikonte do të kishte fuqi vetëm ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit pas hyrjes së tij në fuqi dhe nuk mund të kishte fuqi prapavepruese ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit përpara hyrjes në fuqi të tij. Subjekti citon: *“Për më shumë vërtetohet se unë kam bërë brenda afateve ligjore 3 kërkesa për emërimin tim si gjyqtare në pozicionet e shpallura të lira, por ato nuk janë pranuar nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është përgjegjësia ime që unë nuk jam kthyer të punoj në detyrën e gjyqtarës brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligja për komandimin në institucionet e tjera të drejtësisë”.*

34.1 Për subjektin e rivlerësimit ky rezultat i këtij hetimi nuk përputhet me kërkesat ligjore në fuqi, pasi nga praktika e ndjekur nga Komisioni janë konfirmuar në detyrë inspektorët M. P. dhe Q. Z., të cilët gjithashtu e kishin tejkaluar afatin 3-vjeçar të komandimit.

35. Nga analiza e gjetjeve sipas raportit profesional të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatohet se inspektorja Zhaneta Pira ka aftësi shumë të mira metodologjike. Thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej saj dhe përmbushet në funksion të respektimit të kornizës ligjore dhe nënligjore dhe afateve të vendosura. Në tetë dokumentet ligjore të vëzhguara, veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë dhe nuk ka mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse. Për çdo veprim procedural janë mbajtur aktet e domosdoshme, të cilat i janë bashkëngjitur aktit të verifikimit apo vlerësimit. Baza ligjore identifikohet lehtësisht prej saj në hartimin e raporteve.

35.1 Subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira ka nivel shumë të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, fakt që u konstatua nga përmbajtja e tri dokumenteve të përzgjedhura prej saj, por edhe nga përmbajtja e pesë dokumenteve të përzgjedhura me short. Rezulton se subjekti e identifikon qartë problematikën e çështjes, duke i kushtuar rëndësi këtij hapi të parë në proces. Ajo zotëron dhe shpreh një nivel shumë të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, duke i përditësuar këto njohuri në njohjen e pjesëve të reja të legjislacionit apo edhe vendimeve të reja unifikuese.

36. KLGJ-ja, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2021, ka përcjellë një informacion shtesë lidhur me raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Zhaneta Pira, sipas të cilit rezulton si vijon.

36.1 Në datën 3.6.2021, Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, është vënë në dijeni se nga kërkimi arkivor rezulton që për ish-inspektoren Zhaneta Pira ka një kërkesë nga kryetari i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor dhe dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” si inspektore e Inspektoratit të KLD-së, kërkesë e cila ka qenë në rendin e ditës së mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë datë 23.6.2017. Me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbajtur në datën 17.7.2017, rezulton se kërkesa nuk është shqyrtuar për shkak të mosparaqitjes së inspektores Zhaneta Pira, e cila ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KLGJ-ja, për këtë rast rezulton se znj. Zhaneta Pira është caktuar me urdhrin nr. \*\*\*, datë 14.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të kryer hetimin disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të Apelit për Krime të Rënda.



Subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira, nëpërmjet Memos datë 16.2.2017, ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga ky inspektim në bazë të kërkesës së bërë nga gjyqtari subjekt inspektimi A. M. për përjashtim.

Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në datën 20.2.2017, nuk ka pranuar zëvendësimin e inspektore Zhaneta Pira nga procedura e hetimit disiplinor, pasi nuk ka shkak të përligjur.

Në datën 22.6.2017 nga relacioni i dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë evidentohet fakti se inspektore Zhaneta Pira nuk është paraqitur në asnjë veprim hetimor për këtë çështje dhe nuk ka nënshkruar asnjë akt të këtij hetimi disiplinor.

Në rendin e ditës së mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë datë 23.6.2017, në pikën 7 do të diskutohej propozimi i kryetarit të Këshillit për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” të inspektore së KLD-së, znj. Zhaneta Pira.

Sipas procesverbalit të mbledhjes datë 17.7.2017 rezulton se znj. Zhaneta Pira nuk është paraqitur dhe ka dhënë raport.

36.2 Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2021, i ka kërkuar KLGJ-së informacion mbi ecurinë e procesit disiplinor të iniciuar ndaj inspektore Zhaneta Pira dhe zgjidhjen e tij. Ky institucion në vijim ka informuar Komisionin se bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 96/2016, si dhe në “opinionin” e Komisionit Disiplinor pranë KLGJ-së, ka dërguar praktikën “Mbi veprimtarinë e ish-inspektore së KLD-së, znj. Zhaneta Pira, në proces administrativ dhe vijueshmërinë e saj”, për trajtim të mëtejshëm të saj bazuar në parimet ligjore që normojnë përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, duke e konsideruar znj. Zhaneta Pira me statusin e magjistratit, mbështetur në vendimin nr. \*\*\* të Këshillit të Lartë Gjyqësor. KLGJ-ja ka përcjellë praktikën e plotë të dërguar në ILD në datën 5.10.2021. Kjo praktikë është në proces shqyrtimi.

37. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me këto çështje:

- a) Pse nuk jeni paraqitur ju në inspektimin e urdhëruar?
- b) Si ka vijuar procedura lidhur me këtë praktikë në ILD?
- c) Cilat janë argumentet tuaja për këtë çështje të ndërthurur me procesin tuaj të rivlerësimit.

38. Në vijim të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës së punës si inspektore në Ministrinë e Drejtësisë, në vitin 2005, ka qenë në përbërje të grupit të inspektimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku ushtronte detyrën gjyqtari A. M.. Pas shkeljeve të konstatuara, ky gjyqtar u dërgua për procedim disiplinor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për shkarkim nga detyra. Në vijim, subjekti sqaron se në vitin 2013 është urdhëruar të inspektojë procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ish-kryetari i gjykatës në atë kohë, gjyqtari A. M., i paraqiti zëvendëskryetarit të KLD-së kërkesë për largimin e subjektit të rivlerësimit nga grupi i inspektimit, e cila u pranua. Lidhur me arsyen e mosparaqitjes në inspektimin e urdhëruar të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit sqaron se nga ana e gjyqtarit A. M. është kërkuar largimi i saj nga grupi i inspektimit me pretendimin e konfliktit të interesit. Subjekti argumenton se nisur nga precedenti i mëparshëm me këtë gjyqtar në vitet 2005 dhe 2013 ka vlerësuar se ndodhej në rrethanat e konfliktit të interesit dhe për të mos krijuar dyshime te gjyqtari për njëanshmëri në hetimin disiplinor ndaj tij, paraqiti kërkesën për tërheqje nga Grupi i Punës.

Subjekti i rivlerësimit citon: *“Në këto rrethana nisur edhe nga kërkesa me shkrim e tij drejtuar KLD-së, unë në memon e datës 16.2.2017 kam kërkuar heqjen dorë nga përbërja e grupit të inspektimit. Megjithëse kërkesa ime është drejtuar me shkrim, mua nuk m’u dha nga eprorët e mi asnjë përgjigje lidhur me të dhe shkaqet e mospranimit të saj. Megjithatë unë nuk mora pjesë më pas në përbërjen e Grupit të Punës dhe inspektimi vazhdoi nga pjesa tjetër e grupit”.*

39. Për sa i përket pyetjes së Komisionit mbi vijueshmërinë e procedurës për këtë rast në ILD, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka pasur dijeni se praktika lidhur me kërkesën e Presidentit

të Republikës për shkarkimin e saj është dërguar në ILD: *“Nuk kam asnjë njoftim nga ana e ILD-së dhe nuk mund të sqaroj lidhur me procedurën”*.

40. Lidhur me pyetjen e Komisionit mbi argumentimin e kësaj çështjeje të ndërthurur me procesin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka qenë qëllim i eprorëve të saj në KLD për ta shkarkuar nga detyra në shkelje flagrante të ligjit pa zbatuar asnjë procedurë ligjore. Subjekti citon: *“Pra, përpara se të paraqitej kërkesa për shqyrtim në KLD, duhej të ishte zhvilluar një procedurë e procedimit disiplinor ku të paraqiteshin fakte, dispozitat e shkelura dhe në cilin ligj mbështeteshin ato, për të cilat unë të vihesh në dijeni e të jepja shpjegimet e mia. Si mund të vendoset shkarkimi nga detyra apriori pa respektuar parimet e procedimit disiplinor, pa zbatuar procedurën për procedim disiplinor, pasi unë në asnjë rast nuk jam pyetur e nuk më është treguar asnjë fletë e shkruar. Në ligjin nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, parashikohen 8 masa disiplinore, nga vërejtje konfidenciale e deri te shkarkimi nga detyra. Nga data 16.2.2017 kur unë kam paraqitur kërkesën për tërheqje nga inspektimi e deri në datën 23.6.2017 kur është kërkuar në KLD shkarkimi im, kanë kaluar mbi 4 muaj, kohë në të cilën ata nuk filluan asnjë procedurë disiplinore për mua. Kjo tregon qartë qëllimin e eprorëve të mi në KLD për të më shkarkuar nga detyra, në shkelje flagrante të ligjit, pa zbatuar asnjë procedurë ligjore, pikërisht në mbledhjen e fundit të KLD-së. Ishte e qartë për mua se do të më shkarkonin nëse do të isha paraqitur në mbledhjen e KLD-së, pavarësisht se po shkelej ligji në mënyrë flagrante”*.

41. Në përfundim, lidhur me vlerësimin profesional që duhet të kryejë Komisioni, subjekti i rivlerësimit shprehet se ka ruajtur dhe gëzon statusin e magjistratit të konfirmuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Subjekti citon: *“Unë si subjekt rivlerësimi, bazuar në kërkesat e pikës 3, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: ‘Inspektori rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. \*\*\*, datë 29.4.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ‘Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë’, kam dorëzuar formularin e vetëdeklarimit, tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga unë, të dhëna e dokumente të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe pesë dokumente ligjore të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të organizuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në ambientet e KLGJ-së”*.

41.1 Subjekti i rivlerësimit sqaron se raporti i vlerësimit profesional, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i është dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky Komision në rezultatet e hetimit ka evidentuar gjetjet se subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira ka nivel shumë të mirë mbi legjislacionin dhe jurisprudencën. Pra, për subjektin e rivlerësimit ky raport vlerësimi profesional si magjistrate, përbën 100% të vlerësimit si subjekt.

42. Nga vlerësimi i rrethanave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor është shprehur me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, se subjekti Zhaneta Pira gëzon statusin e magjistratit. Ky vlerësim është kryer nga ky institucion në ushtrimin e funksioneve të tij dhe nuk është i detyrueshëm për procesin e rivlerësimit. Po ashtu, ky vendim është marrë në një kohë të mëvonshme, nga ajo e parashikuar nga ligji për përfshirjen e subjekteve në testim në Shkollën e Magjistraturës. Mospjesëmarrja e subjektit në këtë testim e detyron Komisionin të vlerësojë nëse përbën mospërmblidhje të kriterëve ligjore nga ana e subjektit.

Në vlerësim të trupit gjykues, subjekti ka qëndruar në detyrë përtej afatit ligjor të përcaktuar nga neni 28 i ligjit nr. 9877/2008, i cili vuri një kufizim për personat që ushtronin veprimtarinë e tyre në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë apo ato të administratës së KLD-së, e duke parashikuar se pas këtij afati ato duhet të ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës. Tri kërkesat e bëra nga subjekti i rivlerësimit Zhaneta Pira për pozicione në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Durrës provojnë kërkesat e saj, por ato nuk justifikojnë apo përmblidhin kërkesat e nenit 28 të ligjit. Po ashtu, në periudhën pas përfundimit të mandatit të parë si inspektore në

Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë emëruar me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.9.2010, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo ka qëndruar deri më 27.5.2016 në këtë funksion pa asnjë emërim (apo miratim) dhe, më tej, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2016, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar inspektore për një mandat tjetër. Kjo mbetet një periudhë e pambuluar me leje nga organi kompetent. Subjekti, me ushtrimin e detyrës nga viti 2004 e në vijim, në vlerësim të trupit gjykues nuk ka ruajtur statusin, prandaj duhet t'i nënshtrohej testimit në Shkollën e Magjistraturës. Duke arsyetuar në vijim të bindjes (qoftë edhe të gabuar) së subjektit se gëzon statusin e inspektorit magjistrat, si dhe faktin se në momentin e rivlerësimit është e pajisur me një vendim të KLGJ-së, i cili konfirmon bindjen e saj se është një inspektore magjistrate dhe se e ruan këtë status, si dhe nga vlerësimi i dispozitave ligjore në tërësi, të cilat nuk e konsiderojnë mospërmbushjen e detyrimit sipas germës “b”, të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, si shkak që mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e konsideron të mjaftueshëm vlerësimin profesional të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në 8 dokumentet ligjore për arritjen e nivelit minimal kualifikues të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu edhe neni E i Aneksit të Kushtetutës nuk parashikon klauzola penalizuese për inspektorët lidhur me testimin në Shkollën e Magjistraturës.

Në zbatim të dispozitave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pika 2, “Vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim” prandaj trupi gjykues vlerëson të mos mbajë në konsideratë informacionin e marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2021, mbi një kërkesë nga kryetari i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor dhe dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” si inspektore e Inspektoratit të KLD-së, për subjektin Zhaneta Pira dhe duke vlerësuar se kjo çështje mund të shqyrtohet dhe vlerësohet në vijim nga organet kompetente.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

43. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, një mënyrë pune në pajtueshmëri me pozicionin e saj dhe nuk ka cenuar besimin e publikut. Sjellja e saj për shmangien e pagimit të tatimeve nga një biznesmen në vitin 2006 mbetet një rast i veçuar dhe në vlerësimin tërësor të subjektit nuk mund të ndikojë deri në dhënien e masës disiplinore.

43.1 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues të kërkuar nga ligji në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Zhaneta Pira, inspektore në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 14.1.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Alma FASKAJ**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*